

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE, KORÇE

Nr. _____ Pro.

Date 01.12.2020

Për: *Shqerine, “NIKA” SHPK me NIPT J76705047U adresa : Shkoder Shkoder SHKODER Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”*

Procedura e prokurimit: **Banja publike ne lulishten "Vangjush Mio"**

Numri i referencës së procedurës/loti : **REF-76952-10-28-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim realizimin e punimeve me objekt Banja Publike ne lulishten “Vangjush Mio”.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

- 1. Shoqeria “VALONA KONSTRUKSION” SHPK, NIPT K26330202E me vleren: 1,083,810 (nje milion e tetedhjet e tre mije e teteqind e dhjete) leke.**
- 2. Shoqeria “NIKA” SHPK, NIPT J76705047U me vleren: 1,085,218.58 (nje milion e tetedhjet e pese mije e dyqind e tetembedhjete pike pesedhjet e tete) leke.**
- 3. Shoqeria “VILDEV-CO” SHPK, NIPT K83926001F me vleren:1,127,107 (nje miljon e njeqind e njezet e shtate mije e njeqind e shtate)leke.**
- 4. Shoqeria “AL-DOK” SHPK, J64103601Q me vleren: 1,153,215 (nje miljon e njeqind e pesedhjet e tre mije e dyqind e pesembedhjete) leke.**
- 5. Shoqeria “INFINIT” SHPK, NIPT J74304623M me vleren: 1,168,768 (nje miljon e njeqind e gjashtedhjet e tete mije e shtateqind e gjashtedhjet e tete) leke.**
- 6. Shoqeria “SARK” SHPK, NIPT K52531415H me vleren: 1,418,027 (nje miljon e katerqind e tetembedhjete mije e njezet e shtate) leke.**
- 7. Shoqeria “MENI” SHPK, NIPT J61909018W me vleren: 1,442,480 (nje miljon e katerqind e dyzet e dy mije e katerqind e tetedhjet) leke.**
- 8. Shoqeria “ELDA-VL” nuk ka paraqitur oferte.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1 .Shoqeria “VALONA KONSTRUKSION” SHPK, per arsye se:

1.Per mjetin e paraqitur ne tender kamioncinen me targë AA964DH nuk është paraqitur dokument pronësie. Nga ana e operatorit është paraqitur një kontratë qeraje me nr. 1858 date 13.11.2020 e lidhur me shoqerine DAST per marrjen me qira te automjetit dhe dokumentet leje qarkullimi, certificate kontrolli teknik dhe siguracion por jo certificate pronësie, e cila është kerkuar shprehimisht ne dokumentet e tenderit tek kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, ku shprehimisht per mjetet me qira duhet te paraqitet: *“kontrata e qerases e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronësisë, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit”*.

2.Operatori nuk ka shlyer te gjitha detyrimet e maturuara te energjise elektrike ne kundërshtim me kërkesat e dokumenteve te tenderit ku kerkohet: *“Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”*. Sipas vërtetimit te dates 13.11.2020 te nenshkruar elektronikisht, operatori ekonomik valona konstrukcion rezulton me detyrime ne vleren 264692.08 leke te cilat sipas vërtetimit jane detyrime per te cilat është një aktmarreveshje aktive. Fakti qe midis operatorit tuaj dhe operatorit te shperndarjes se energjise elektrike ekzistojne një marreveshje aktive per shlyerjen e detyrimeve kjo nuk e ben oferten te kualifikueshme ne kuptim te ligjit per prokurimin publik sipas te cilit: *“Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë”*.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqerie per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

2 . Shoqerita “SARK” SHPK per arsye se:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur oferten sipas kërkesave te autoritetit kontraktor sepse ne formularin e ofertes, preventivin e punimeve nuk ka parashikuar 5 (pese) % fond rezerve te kerkuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit.

Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te kesaj shoqerie per gabime aritmetikore, rezultoi se oferta ishte e rregullt dhe nuk kishte gabime aritmetike.

Nga verifikimi i bere ne Regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per personat e deklaruar rezultuan te pa denuar.

3 .Shoqeria “ELDA-VL” SHPK per arsye se:

Kjo shoqeri ***nuk*** ka paraqitur oferte si dhe asnjë dokument ligjor, administrativ, kualifikues të përcaktuara në dokumentat e tenderit, per kete arsye komisioni e ka objektivisht te pamundur te verifikoje gjendjen gjyqesore.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine “**NIKA**” SHPK se oferta e paraqitur, me cmim total me vlere prej **1,085,218.58 leke (nje milion e tetedhjet e pese mije e dyqind e tetembedhete pike pesedhjet e tete) leke pa Tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike, Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **20.11.2020***

Ankesa: **Nuk ka**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ILIRJAN DINELLARI**